



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTTRRI

Numri i lëndës: 2019:127303

Datë: 20.10.2021

Numri i dokumentit: 02300373

P.nr.100/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me procesmbajtësen Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit I. B. nga fshati Sh. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1250/15 e datës 13.03.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 11.10.2021, në praninë e Prokurorit të shtetit Sllobodan Bakic, të pandehurit I.B. avokatit mbrojtës me autorizim av. Abit Asllani dhe të dëmtuarit H. H. pas shpalljes së aktgjykimit me datë 11.10.2021, me datë 20.10.2021 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: I. B. nga i ati A. e ëma M. e vajzërisë C. i lindur më ..., në fshatin Sh. komuna e Vushtrrisë, i pa punë – veteran i luftës, i martuar, prind i shtatë fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal 1021246391 të lëshuar nga MPB-ja, edhe më parë i gjykuar me aktgjykimin P.nr.447/2007.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 07.07.2015, rreth orës 10:30 min, në Vushtri, në objektin e Agjencionit të Pylltarisë, i pandehuri e ka kanosur seriozisht teknikun e Pylltarisë – të dëmtuarin H. H. gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ashtu që së bashku me vëllezërit e tij R.dhe K. duke qenë nervoz dhe gjendje agresive ka hyrë në zyrën e Agjencionit ku ishte pylltari – i dëmtuari H. H. dhe i është drejtuar me fjalët “kush ju ka marrë drutë djemve tanë edhe nëse ti me atë të dumnicsës (duke aluduar në pylltarin Xh. I.) nuk i bini 50 euro deri në mbrëmje kini me pasur punë me mua” dhe atë në prezencë të dëshmitarit Petrit Krasniqi, i cili kishte shkuar të rregullon dokumentacionin për vete në këtë zyrë, kanosje kjo që kishte shkaktuar frikë dhe ankth tek i dëmtuari dhe për këtë arsye e kishte lajmëruar policinë

- **Me këtë ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit, 4, 7, 17, 21, 41, 43, 46, 62, 73, 74, 185 të KPPK-së, dhe nenit, 365, 450, si dhe 461 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURIT: I. B. i shqipton **DËNIM ME BURG** në kohëzgjatje prej njëmbëdhjetë (11) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i njëjti nuk kryen veprën penale tjetër në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Pala e dëmtuar H. H. ka hequr dorë nga kërkesa pasurore – juridike lidhur me këtë çështje penale.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë (30) euro.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëzet (20) euro.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1250/15 e datës 13.03.2018 kundër të pandehurit I.B. nga fshati Sh. komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 185 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datën 11.10.2021 në të cilën seancë i pandehuri ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën e kryer, se është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale si dhe i premtonte gjykatës se në të ardhmen kjo veprë nuk do të përsëritet më, ka qenë në gjendje të rëndë emocionale për shkak se një djalë i tij vuan nga sëmundja e epilepsisë dhe se nuk e ka përsëritur më veprën penale nga viti 2015.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm i bazuar në provat materiale si në aktakuzë dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e shqyrtimit të dënimit ta marrë parasysh pranimin e fajësisë si rrethanë lehtësuese, si dhe faktin se vepra penale është kryer para gjashtë viteve, nuk e ka përsëritur më veprën penale dhe është pajtuar me të dëmtuarin.

I dëmtuari lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë, rasti ka ndodhur para gjashtë viteve dhe beson se ka qenë i momentit, nuk

kanë pasur probleme asnjëherë me të pandehurin dhe ka deklaruar se heq dorë nga kompensimi i dëmit lidhur me këtë çështje penale.

Avokati mbrojtës i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se i bashkëngjitet pranimit të fajësisë, pranimi është bërë pas konsultimit me avokatin mbrojtës, duke u bazuar në deklarin e palëve i ka propozuar gjykatës që të shqiptojë një dënim sa më të butë pasi që do të jetë i mjaftueshëm që i njëjti të mos përsërisë veprën penale.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë nga e pandehurit.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raporti fillestar i incidentit i datës 07.07.2015, Raporti i oficerit i datës 07.07.2015, Raport policor mbi marrjen në pyetje të ankuesit Q. Q. i datës 07.07.2015, Raporti policor mbi marrjen në pyetje të ankuesit H. H. i datës 07.07.2015, Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit I. B. i datës 07.07.2015, Raporti policor i datës 07.07.2015, Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit K. B. i datës 07.07.2015, Procesverbal mbi intervistimin e të dyshuarit R. B. i datës 07.07.2015.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, rrezikshmërinë e kësaj veprë penale, përkatësisht intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, dhe faktin se i njëjti ka qenë edhe më parë i gjykuar ma aktgjykimin P.nr.447/2007, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale dhe faktin se është pajtuar me të dëmtuarin dhe se vepra penale është kryer para gjashtë viteve dhe i njëjti nuk e ka përsëritur më.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me kusht ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 par. 1 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike sa i përket të dëmtuarit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 461 të KPPK-së pasi që pala e dëmtuar në seancën e shqyrtimit fillestar ka hequr dorë nga kompensimi i dëmit material lidhur me këtë çështje penale.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.100/2018, datë: 20.10.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.